REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË LËNA NËPËRMJET REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2022

Nr	Detyra	Gjendja	Shpjegime
1	Të përgatisë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore për procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, strukturën e pagës, përmirësimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës, përmirësimin e metodologjisë së vlerësimit të rezultateve të punës, pezullimit, lirimit, transferimit, me qëllim përmirësimin e përcaktimeve ligjore për këto çështje.	Realizuar	Bazuar në rekomandimet e lëna nga Kuvendi në rezulotën për zbatimin e legjislacionit për nëpunësin civil për vitin 2022, rekomandimet e lëna nga Grupi i Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE- Shqipëri (PAR SG) në lidhje me forcimin e zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil, si dhe në analizën e bërë ndër vite nga vetë DAP-i u parashikua që gjatë vitit 2022 të hartoheshin ndryshimet e nevojshme në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Në vijim të angazhimit të marrë: 1. Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2022, DAP-i në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil filloi punën dhe hartoi një draft të parë të projektligjit për ndryshime në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nëpërmjet të cilit synohet të realizohet sa vijon: ✓ Rregullime në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, si dhe me procesin e rekrutimit për të gjitha kategoritë e nëpunësve civilë; ✓ Rregullime në lidhje me afatin e pezullimit të nëpunësve civilë që zgjidhen si anëtarë të këshillave bashkiakë; ✓ Rregullime në lidhje me rastet e lirimit nga shërbimi civil, ristrukturimit, pezullimit, ecurisë disiplinore, etj; ✓ Rregullime në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë; ✓ Rregullime në lidhje me procesin e vlerësimit të punës së nëpunësve civilë; ✓ Rregullime në lidhje me kriteret për përparimin në hapat e pagës;

			✓ Rregullime në lidhje me organizimin dhe funksionimin e ASPA-s. Ndërkohë, për shkak të zhvillimeve në lidhje me procesin e negociatave për anëtarësimin në BE, mbajtuar në konsideratë që fusha që ligji mbulon është pjesë e raportimeve në fushën e Reformës së Administratës Publike, u vlerësua që drafti përfundimtar dhe dërgimi për miratim i tij të bëhej pas përfundimit të takimeve bilaterale, si dhe rekomandimeve që do na vijnë nga BE-ja në raportin e tyre "screening", për të bërë të mundur që ndërhyrjet në të, të jenë në linjë me kërkesat e procesit të integrimit evropian.
2	Të hartojë një manual për planifikimin vjetor të burimeve njerëzore, si dhe të bashkëpunojë me të gjitha institucionet e administratës shtetërore duke krijuar një plan pune të zbatueshëm për përmirësimin e procesit të planifikimit vjetor të nevojave për rekrutim, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil".	Realizuar	Gjatë vitit 2022, DAP-i hartoi dhe miratoi udhëzimin mbi procesin e planifikimit të nevojave për rekrutim në shërbimin civil për institucionet e administratës shtetërore. Nëpërmjet këtij udhëzimi përcaktohen elementët proceduralë dhe materialë të procesit të planifikimit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duke mundësuar zbatimin e unifikuar të procesit nga njësitë e burimeve njerëzore, dhe konkretisht: a) Si kryhet identifikimi i vendeve vakante; b) Afatet e realizimit të çdo faze të planifikimit; c) Detyrat e strukturave përgjegjëse; d) Elementët që duhet të përfshihen në planin vjetor të pranimit. Në vijim gjatë vitit 2023, nëpunësit e ngarkuar me këtë proces në institucionet e administratës shtetërore do të vijojnë të trajnohen.
3	Të vijojë aplikimin e trajnimeve online për administratën vendore për procedurat e popullimit të sistemit	Në proces	Sulmi kibernetik ndaj infrastrukturës dhe sistemeve shtetërore, ndikoi ndërmjet të tjerave edhe në trajnimin e nëpunësve për HRMIS-in dhe platformën e bashkëpunimit "administrata.al", për shkak të masave që u morën në lidhje me sigurinë e këtyre sistemeve nga AKSHI. Në këtë kuptim gjatë vitit 2022, DAP-

	HRMIS dhe platformës "administrata.al".		i u përqëndrua në ruajtjen e status quo-së, pasi nuk ishte e mundur përfshirja e institucioneve të tjera në këto sisteme.
4	Të ndjekë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj gjyqfituesve, si dhe marrjen e masave nga ana e institucioneve për të mbajtur sa më të ulët numrin e ankesave të reja.	Realizuar	Masat e ndërrmarra në vite (siç është konsolidimi i bazës ligjore dhe asistimi i institucioneve të administratës shtetërore nga DAP-i) kanë ndihmuar dhe lehtësuar punën e të gjitha institucioneve për zbatimin me rigorozitet të procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Si rezultat konstatojmë se nga viti në vit ka një rritje të numrit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke e çuar këtë numër që nga viti 2014, në gjithsej 380 vendime, në krahasim me 361 që ishin në fund të vitit 2021. Për sa i përket numrit të ankesave të paraqitura në gjykatë gjatë vitit 2022, situata është si vijon: - Janë regjistruar për gjykim në gjykatën administrative të shkallës së parë 48 raste të reja, nga 49 që ishin gjatë vitit 2021, ose 2% më pak. Për 27 prej tyre ka përfunduar gjykimi dhe 21 prej tyre janë ende në proces; - Nga 27 çështjet e përfunduara në gjykim në shkallën e parë, për 19 prej tyre është rrëzuar kërkesë padia e nëpunësit, pra janë në favor të institucionit. Në përqindje, gjatë vitit 2022, janë 70.4% e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të institucionit, shifër kjo pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2021; - Nga 27 çështjet e përfunduara në gjykim në shkallën e parë, për 8 prej tyre është pranuar kërkesë padia, pra janë në favor të nëpunësit. Në përqindje, gjatë vitit 2022, janë 29.6% e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të nëpunësit, shifër kjo pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2021.
5	Të angazhohet në hartimin e bazës ligjore dhe funksionimin e platformës "administrata.al".	Realizuar	Funksionimi i platformës së bashkëpunimit "administrata.al" rregullohet me vendimin nr. 833, datë 28/10/2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të

			personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit". Pra baza ligjore për këtë platformë është e miratuar.
6	Të rrisë ndërveprimin me qytetarët nëpërmjet publikimit në portalin online të aplikimit, të informacioneve që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.	Realizuar	> Me qëllim informimin e publikut për procedurat e konkurrimit, edhe gjatë vitit 2022, krahas publikimit të procedurave në faqen ëeb të DAP-it, janë bërë postime të shpeshta edhe në faqen e facebook të institucionit, ku janë dhënë njoftime lidhur me procedurën e konkurrimit në shërbimin civil. > Gjatë vitit 2022, një vëmendje e veçantë i është kushtuar komunikimit në rrjetet sociale si një rrugë për të përcjellë njoftimet, zhvillimet dhe këshillat për nëpunësit e administratës publike apo personat që kanë interes për t'u bërë pjesë e ekipit të administratës publike. > Në rrjetet sociale të DAP-it dhe në faqen zyrtare të tij publikohen rregullisht video të cilat sqarojnë procesin e rekrutimit, duke filluar nga aplikimi e deri në përzgjedhjen e pozicioneve në përfundim të procesit të testimit.
7	Të krijojë një hapërsirë të dedikuar në faqe për seksionin pyetje përgjigje për palët e interesuara, institucionet publike apo individë për interpertimin e dispozitave të legjislacionit në fushën e shërbimit civil dhe administratës publike.	Në proces	Për shkak të sulmit kibernetik, gjatë vitit 2022 nuk ishte e mundur të bëheshin zhvillime në faqen e DAP-it për shkak të masave të ndërmarra të sigurisë. Ky është një proces që synojmë ta realizojmë gjatë vitit 2023.
8	Në zbatim të udhëzimeve të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil për zbatimin e detyrimeve të administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, të hartohen plane pune monitorimi dhe	Realizuar	Në Shkurt të vitit 2023, për shkak të zgjedhjeve vendore, KMSHC-ja hartoi udhëzimin nr. 11, datë 10.02.2023, në të cilin përcaktoi disa kufizime lidhur me procesin e rekrutimit dhe sjelljen e nëpunësve gjatë fushatës zgjedhore. Në vijim DAP-i përcaktoi përfaqësues për çdo sistem ministror, të cilët duhet të realizojnë mbikqyrjen gjatë fushatës zgjedhore.

	të paraqiten raporte analitike për përmbushjen e detyrimeve të nëpunësve civilë dhe institucioneve që punësojnë nëpunës civilë gjatë periudhës zgjedhore.		
9	Të sigurojë një vlerësim sa më objektiv gjatë procesit të rekrutimit për të gjithë nëpunësit civilë duke shtuar vëmendjen tek ata me profil arsimor në fushën e drejtësisë, si dhe të garantojë një trupë nëpunësish civilë me performancë të lartë në të gjitha nivelet e administratës nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme, me qëllim rritjen profesionale veçanërisht për punonjësit të cilët kanë një profil arsimor në drejtësi.	Realizuar	> Gjatë vitit 2022, ASPA ndërmorri iniciativën për hartimin e një kurrikule të plotë dhe të posaçme në lidhje me zbatimin e përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative (27 orë trajnimi në total). Si rezultat, në periudhën nëntor – dhjetor të vitit 2022, u zhvilluan sesionet përkatëse me nëpunës të njësive juridike nga ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë. Ky proces vijon edhe gjatë vitit 2023. > Gjithashtu, gjatë tre mujorit të fundit të vitit 2022, ASPA shpalli aplikimin për trajnerë për hartim kurrikule dhe dhënie trajnimi në lidhje me ciklin e hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore (duke filluar që nga identifikimi i një politike apo angazhimi të caktuar e deri në hartimin e aktit përkatës). Pas rekrutimit të trajnerëve ka filluar puna për hartimin e kurrikulës përkatëse, e cila parashikohet të implementohet gjatë vitit 2023.